



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.62

Prishtinë, më 19.9.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi dhe Mufera Shinik.

Munguan: Bekim Haxhiu dhe Ismajl Kurteshi.

Përfaqësues të tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja, KDI-ja dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.9.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-066 për Profesione të Rregulluara në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.9.2016

Rendi i ditës dhe procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës

Nait Hasani, njoftoi anëtarët e Komisionit me raportet e Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr.05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë Projektligj, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 14.9.2016, ka shqyrtuar Projektligjin për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës me amendamentet e Komisionit Funkcional, dhe ka vlerësuar se Projektligji dhe disa nga amendamentet e propozuara përmbajnë kosto buxhetore shtesë, për çka kërkohet analizë më e hollësishme e dispozitave të Projektligjit në aspektin e ndikimit buxhetor të tij, dhe informata shtesë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si hartuese e Projektligjit. Komisioni për Buxhet ka formuar një grup punues prej tre anëtarësh, i cili është i obliguar që në afatin prej dy javësh, të shqyrtojë Projektligjin dhe amendamentet e propozuara dhe të paraqes raportin me rekomandime për shqyrtim në komision.

Kryesuesi propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet pas vlerësimit të kostos buxhetore nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Nait Hasani, tha se Komisioni ka pranuar raportet me rekomandime nga Komisionet e përhershme për Projektligjin nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, të cilat rekomandojnë që Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohen për lexim të dytë.

Kryesuesi propozoi që Projektligji nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të procedohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni me shumicë votash vendosi që ta procedojë për lexim të dytë Projektligjin nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Nait Hasani, theksoi se Projektligji nr.05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, është proceduar në Kuvend dhe janë plotësuar kushtet për shqyrtim në parim. Ky Projektligj është i një rëndësie të veçantë dhe gjatë amendamentimit do të shqyrtohet mundësia që Inspektorati i Arsimit të funksionojë si organ i pavarur nga ministria. Pas leximit të parë, do të organizojmë dëgjim publik me grupet e interesit, si dhe do të respektojmë afatet kohore për procedimin e tij për lexim të dytë.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që për shkak të rëndësisë së veçantë që ka Projektligji për ngritjen e cilësisë në arsim, ta përkrahin në parim dhe të procedohet me tutje për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni, me shumicë votash miratoi në parim Projektligjin nr.05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe nxori këtë rekomandim:

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji nr.05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

6. Të ndryshme

Teuta Haxhiu, ngriti çështjen e fillimit të vitit shkollor dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore. Ajo tha se ka informacione se në disa DKA kanë mbetur tekste shkollore nga viti i kaluar dhe të njëjtat nuk janë shpërndarë. Haxhiu kërkoi që të ftohet ministri dhe të raportojë lidhur me keqpërdorimet për botimin dhe shpërndarjen e teksteve. Ajo propozoi që Komisioni të realizojë vizitë në disa nga bartësit privat të arsimit të lartë dhe Agjencinë e Akreditimit.

Nait Hasani, tha se Komisioni në mbledhjen e kaluar ka diskutuar lidhur me angazhimin e një eksperti për Projektligjin për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe Projektligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive dhe kërkoi deklarimin e anëtarëve të Komisionit për angazhimin e tij.

Anëtarët e Komisionit me shumicë votash, morën vendim që z.Xhevdet Smakiqi të angazhohet si ekspert ligjor për Projektligjin për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe Projektligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Ngarkohet grupi punues dhe koordinatori i Komisionit, që brenda 5 ditëve pune të përgatisin termat e referencës, ku definohen përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani